

VENDIM
Nr. 353, datë 4.6.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 173, DATË 26.3.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË
MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË
DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2014”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 3, e 7, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, si dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 3 të vendimit nr. 173, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Nënndarja “i”, e shkronjës “n” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i) Ndërtimin dhe/ose rikonstrukcionin e ambienteve që shërbejnë:

- për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës dhe bimëve medicinale;
- për mbarështimin e kafshëve dhe shpendëve.”.

2. Nënndarja “i” e shkronjës “nj” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i) Ndërtimin dhe/ose rikonstrukcionin e ambienteve që shërbejnë:

- për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës dhe bimëve medicinale;
- për mbarështimin e kafshëve dhe shpendëve.”.

3. Pas shkronjës “nj” shtohet shkronja “o”, me këtë përmbajtje:

“o) Mbështetja e prodhimit në serra me ngrohje qendrore përmes financimit të lëndës djegëse në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë/dyn, për serrat që përdorin si lëndë djegëse naftë, dhe 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë/dyn për serrat që përdorin lëndë djegëse solar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama